

Udhëzues për  
gazetarë lidhur  
me  
**raportimin  
nga gjykata**



Shtator 2023

# PARATHËNIE

Gazetarët në mbarë botën bartin përgjegjësi të madhe kur bëhet fjalë për të siguruar që lexuesit dhe shikuesit të kenë qasje në raportim të saktë dhe në kohë të zhvillimeve të rëndësishme. Këtu nuk bën përjashtim as raportimi mbi procedurat gjyqësore me interes më të gjerë publik.

Prandaj, kemi kënaqësinë të paraqesim udhëzuesin e parë për gazetarë lidhur me raportimin nga gjykimet, të përpiluar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Hartimi i këtij udhëzuesi është në pajtim me mandatin e Misionit për të nxitur respektimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së fjalës, sepse që të dyja janë shumë të rëndësishme si për funksionimin e mirëfilltë të shoqërive demokratike ashtu edhe për ofrimin e sigurisë në përgjithësi.

Raportimi cilësor duhet të sfidojë, por edhe të informojë, duke u kërkuar llogari zyrtarëve publikë për veprimet dhe vendimet e tyre. Ky udhëzues është hartuar për t'i mbështetur gazetarët në punën e tyre, për t'u ndihmuar që të shkruajnë raporte të sakta, të vërteta dhe të balancuara të proceseve gjyqësore, duke iu përmbajtur standardeve më të larta të gazetarisë dhe kodeve të përcaktuara të etikës.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për dëmin që shkaktohet nga garkullimi i informacionit të rremë ose lajthitës. Përhapja e informacionit të rremë mund të minojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe të dëmtojë proceset demokratike. Kjo dobëson njëherit dhe besueshmërinë e medias.

Në të njëjtën kohë, nuk duhet të harrojmë kurrë rolin e gazetarisë së përgjegjshme për të siguruar që publiku të ketë qasje në informacione të sakta dhe spektrin e tërë të pikëpamjeve, e as rreziqet me të cilat gazetarët përballen shpesh në punën e tyre.

Publiku ka të drejtë të dijë se si funksionojnë institucionet e tij, përfshirë gjykatat, si i menaxhon qeveria burimet publike dhe nëse legjislacioni zbatohet në praktikë. Për ta bërë të mundur këtë, gazetarët kanë nevojë për përkrahje.

Ky udhëzues është fryt i punës së kolegëve të mi të përkushtuar të Misionit të OSBE-së. Megjithatë, hartimi nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e fuqishme të partnerëve tanë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës, Komisionin e Pavarur për Media, Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), si dhe ekspertëve të së drejtës mediale, që me dashamirësi kontribuan me ekspertizën e tyre në përgatitjen e udhëzuesit.

U jam mirënjohës gjithë atyre që kanë punuar kaq shumë për të hartuar këtë dokument. Shpresoj sinqerisht që udhëzuesi me të vërtetë do të ndihmojnë në orientimin e gazetarëve përbrenda kompleksitetit të sistemit gjyqësor të Kosovës si dhe t'i përforcojë njohuritë e gazetarëve rreth të drejtave dhe përgjegjësi të tyre ndërsa punojnë për të informuar publikun për procedurat në gjykatat e Kosovës.



**Michael Davenport**

Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë

# HYRJE

Ky udhëzues është i dedikuar për gazetarët që raportojnë nga dhe lidhur me gjykatat e Kosovës. Ai do të shërbejë si udhëzues themelor që përshkruan rregullat, strukturën e institucioneve të drejtësisë, legjislacionin në fuqi dhe standardet e sjelljes të cilave duhet t'u përmbahet një gazetar profesionist i cilitdo nivel eksperience para se të raportojë për gjykimet publike nga gjykatorja, me theks të veçantë në procedurat penale. Është detyrim dhe përgjegjësi e secilit gazetar që t'i kuptojë dhe zbatojë këto praktika të mira kur raporton nga gjykata dhe rreth proceseve gjyqësore. Nëse gazetari nuk ka njohuri për ndonjë term, proces apo lëndë të një rasti gjyqësor, ai ose ajo duhet të kërkojë udhëzime nga ndonjë zyrtar me përvojë të informimit publik, avokat ose gjyqtar.

Udhëzuesi përbëhet nga tri pjesë:

- 1. Raportimi nga gjykata**
- 2. Standardet e privatësisë dhe mbrojtjes dhe**
- 3. Pasqyrim i kornizës ligjore dhe asaj normative që rregullon këto standarde.**

Udhëzimet fillojnë me referenca të shpejta mbi ato që duhen dhe nuk duhen të ndodhin në raportimin mbi gjykatat, që shpjegohen më thellësisht në pjesën e parë dhe të dytë. Pjesa e tretë jep një perspektivë përmbledhëse të nivelit të lartë të strukturës së gjykatave, termave teknike kyçe që gazetarët mund t'i hasin kur raportojnë nga dhe rreth gjykatave, si dhe mekanizmat kryesorë ligjorë që rregullojnë raportimin nga gjykatat.





# REFERENCA TË SHPEJTA

## DUHET ✓

- ✓ Të respektohen standardet profesionale dhe etike gjatë raportimit mbi procedurat gjyqësore.
- ✓ Të respektohet konfidencialiteti dhe urdhrat e gjykatës.
- ✓ Të jeni të njoftuar me sistemin gjyqësor në Kosovë.
- ✓ Të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë para vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe i njëjti të pasqyrohet në shkrim.
- ✓ Të raportohet në mënyrë të paanshme, të balancuar dhe të saktë, duke i prezantuar të gjitha anët në secilin rast gjyqësor.
- ✓ Të kërkohen udhëzime nga ndonjë zyrtar me përvojë për informim publik, avokat ose gjyqtar, në rast se gazetari nuk është i njohur me ndonjë fushë të ligjit.
- ✓ Të përdoren burime të cilat kanë njohuri të besueshme dhe të dorës së parë.
- ✓ Të mbështeteni në burimet e identifikuar të informacionit.
- ✓ Të bëhen përpjekje për identifikim të të gjitha burimeve, por edhe të sigurohet mbrojtja e identitetit të ndonjë burimi kur kjo është e nevojshme.
- ✓ Të ushtrohet e drejta për heshtje në lidhje me burimet tuaja.
- ✓ Të shpjegohet pse burimi ka kërkuar anonimitet.
- ✓ Të zbulohet identiteti i burimit me kërkesë të gjykatës kompetente, nëse është e nevojshme për të parandaluar ndonjë kërcënim serioz.
- ✓ Të trajtohen me ndjeshmëri, dhe vetëm kur janë me interes publik, temat që flasin për tragjedi personale.
- ✓ Të mbrohet identiteti i fëmijëve dhe të rriturve të cenusshëm që ballafaqohen me procedura penale – kjo është e drejtë e tyre.
- ✓ Të ushtrohet kujdes dhe ndjeshmëri kur vendoset të publikohen informata për të akuzuarin ose të dyshuarin në lidhje me hetimet penale.
- ✓ Të korrigjohen informatat e publikuara që vërtetohen të jenë të pasakta.
- ✓ Të bëhet dallim i qartë midis lajmeve dhe opinioneve, duke përjashtuar shpifjen dhe fyerjen.

## NUK DUHET X

- ☒ Të trajtohet cilido individ si fajtor për ndonjë vepër përpara vendimit të prerë gjyqësor për atë çështje.
- ☒ Të zbulohen informatat konfidenciale.
- ☒ Të publikohen informata të rreme ose lajthitëse.
- ☒ Të paraqitet vetëm njëra anë e rastit.
- ☒ Të mos përfillen parimet e mosdiskriminimit dhe të drejtave të komuniteteve joshumicë dhe përkatësive të tjera, përfshirë ato me bazë të gjuhës, komunitetit, fesë, orientimit seksual, politikës ose statusit socio-ekonomik.
- ☒ Të komunikohet çdo gjë që dihet për rastin, si emrat e viktimave, dëshmitarëve dhe të miturve dhe fotografitë nga vendet e ngjarjes.
- ☒ Të mbështeteni në një burim të vetëm për materiale kundërthënëse ose kontestueshme.
- ☒ Të mbështeteni në burime anonime që nuk janë të besueshme dhe që nuk kanë qasje të dorës së parë në informacion.
- ☒ Të hetohet jeta private e ndonjë individi, përveç nëse ka interes publik.
- ☒ Të intervistohen apo fotografohen fëmijët nën moshën 18 vjeç pa pëlqimin e të rriturit përgjegjës për fëmijën.
- ☒ Të shtrembërohen apo keqpërdoren deklaratat e dhëna në kontekste të caktuara.
- ☒ Të publikohen emrat e dëshmitarëve që do të dëmtonin gjykimin apo do të çonin në kërcënime ndaj tyre.
- ☒ Të zbulohen informacione personale që do të cenonin privatësinë ose sigurinë e viktimave, dëshmitarëve (sidomos dëshmitarëve të mbrojtur) apo të akuzuarve.

# 1. RAPORTIMI NGA GJYKATAT

## 1.1 E drejta për qasje

Përfaqësuesit e medias kanë të drejtë t'i ndjekin proceset gjyqësore për të siguruar transparencën e drejtësisë në shumë raste.

Shumica e gjykimeve janë të hapura për publikun. Çdokush ka të drejtë të marrë pjesë në to, në shumicën e rasteve.<sup>1 2</sup> Gazetarët duhet të jenë në gjendje që të raportojnë lirshëm për proceset gjyqësore, ashtu që t'i japin publikut informacion për veprimtarinë e autoriteteve gjyqësore.<sup>3</sup> Publiku ka të drejtë dhe interes legjitim të informohet për veprat penale dhe gjykimet.<sup>4</sup> Është përgjegjësi e mediave që të raportojnë për këto çështje. Zyrtarët gjyqësorë duhet t'i pranojnë gazetarët në seancat gjyqësore publike dhe shpalljet publike të aktgjykimeve pa diskriminim, si dhe pa kushtëzime paraprake për akreditim.<sup>5</sup> Ndërsa e drejta për gjykim publik është e rëndësishme (dhe është bazë për mediat ose qytetarët që marrin pjesë në gjyqe), ajo nuk është e drejtë absolute dhe mund të kufizohet në raste të caktuara (p.sh., për të mbrojtur sigurinë e dëshmitarëve, viktimave të cënueshme, të miturve, etj.), siç theksohet në vijim. Disa informata të rasteve janë publike, e të tjerat private (sidomos në fazën e hetimit, si dhe nëse lidhen me të drejtat e privatësisë).<sup>678</sup>

## 1.2 Si të sigurohet qasja në gjykata

Për të qenë në pajtim me standardet evropiane të të drejtave të njeriut, gjykatat duhet t'i vënë oraret e gjykimeve në dispozicion të publikut, përfshirë gazetarët.<sup>9</sup> Oraret e gjykimeve në Kosovë janë publike. Gazetarët mund t'iu qasen atyre nga faqja e internetit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.<sup>10</sup> Autoritetet gjyqësore duhet të ofrojnë rregullisht informata të sakta për mediat rreth procedurave në zhvillim e sipër, për aq sa kjo nuk ndikon apo vonon procedurat gjyqësore.<sup>11</sup> Për më tepër, gjykatat duhet t'u

ofrojnë gazetarëve qasje dhe t'u lejojnë shpërndarjen e vendimeve gjyqësore të shpallura publikisht.<sup>12</sup>

### 1.3 Prania e mediave në gjykatore

Zyrtarët gjyqësorë mund t'u kërkojnë gazetarëve të identifikohen. Për të siguruar qasje të pandërprerë në gjykata, është e domosdoshme që gazetarët dhe mediat t'i respektojnë rregullat e gjykatës.<sup>13</sup> Të pranishmit, përfshirë gazetarët, duhet të ngrihen në këmbë kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kolegji i gjyqtarëve (që quhet edhe trup gjykues) hyn ose del nga salla e gjyqit. Gazetarët duhet, për shembull, të instalojnë kamerat dhe pajisjet tjera përpara se të fillojë gjykimi. Kamerat duhet ta kenë të fikur blicin gjatë shkrepjes së fotografive. Gazetarët duhet të shkruajnë me kujdes në laptop/telefon dhe të ndalin secilën zhurmë, ashtu që të mos ndërpresin apo/dhe pengojnë gjykimin.

### 1.4 Kushtet për kufizim të raportimit nga gjykatat

Liria e shprehjes nuk është e drejtë absolute.

Në raste të caktuara, gjykimet mund të jenë të mbyllura për publikun, duke përfshirë ato raste kur gazetarët raportojnë nga gjykatat.<sup>14 15</sup> Këtu përfshihen edhe rastet ku ka implikime të “respektimit të të drejtave dhe të reputacionit të të tjerëve” dhe “mbrojtjes së sigurisë kombëtare apo të rendit publik...”.<sup>16</sup> Gjyqtari mund të urdhërojë përjashtimin e publikut nga procedura vetëm atëherë kur interesi i mbështetur nga mbyllja tejkalon ndjeshëm interesin publik për procedurë të hapur.<sup>17</sup>

Kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues vendos nëse do të lejojë incizimin e seancave publike.<sup>18 19</sup> Në raste të caktuara, gjyqtari mund të urdhërojë që shqyrtimi gjyqësor të mos incizohet ose që ta përjashtojë publikun dhe mediat gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij.<sup>20</sup> Këtu përfshihen situatat kur kjo është e nevojshme për ruajtjen e integriteti i proceseve të vendimmarrjes

gjqësore, mbrojtjen e sigurisë kombëtare, mbrojtjen e interesave të fëmijëve, ruajtjen e rendit dhe ligjit, apo mbrojtjen e privatësisë së palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve.<sup>21 22 23</sup> Nëse gazetarët nuk i binden urdhrin për të mos regjistruar procedurat gjyqësore, gjyqtari mund t'i dënojë ata për mosbindje ndaj gjykatës. Mosbindja ndaj urdhrin të gjykatës dënohet me gjobë ose me burgim.<sup>24</sup>

Gjithashtu, gazetarët duhet të kuptojnë se gjyqtarët dhe avokatët mund të mos jenë në gjendje të komentojnë mbi ndonjë rast aktual për arsyt e lartpërmendura, megjithëse mund të lejohen shpjegime të hollësishme dhe juridike. Ngjashëm, në rastet penale, gazetarëve mund t'u duhet të nxjerrin qëndrimin e prokurorisë nga dokumentet e shkruara të gjykatës kur prokurori nuk dëshiron ose nuk është në gjendje të flasë me gazetarin, siç edhe parashihet me legjislacionin për komunikimin e prokurorit me median.<sup>25</sup>

## 1.5 Njoftimet e pabazuara nga mediat

Është obligim i përfaqësuesve të mediave që të botojnë reagime ndaj apo demante të informacioneve të pasakta të publikuara nga to.

Personat dhe organizatat kanë të drejtën e reagimit dhe të drejtën e korrigjimit të kritikave të pabaza publike të botuara në mënyrë të pasaktë për ta.<sup>26 27 28 29 30 31</sup> Për më tepër, gjykata mund t'i sanksionojë mediat nëse raportojnë informacione të pasakta për dënime të paarsyeshme apo arrestim të pabazë të ndonjë personi, dhe me këtë cenohet reputacioni i personit.<sup>32</sup> Në raste të tilla, gjykata, me kërkesë të personit në fjalë ose familjarëve të tij/saj, mund t'u kërkojë mediave që të raportojnë për vendimin dhe të sqarojnë se dënimi ka qenë i paarsyeshëm ose arrestimi i pabazë. Personi përkatës ose familja e tij/saj mund të parashirojnë kërkesë të ngjashme edhe kur gjykata e prish ligjërisht një aktgjykim, nëse

aktgjykimi i mëparshëm dhe i prishur më vonë dëmton rëndë reputacionin e personit të dënuar. Kërkesa e tillë duhet të parashtrahet brenda gjashtë (6) muajsh në gjykatën që ka udhëhequr procedurën penale në shkallë të parë.<sup>33</sup>

## **2. STANDARDET E PRIVATËSISË DHE MBROJTJES NË RAPORTIMIN GJYQËSOR**

### **2.1 Burimet anonime**

Gazetarët duhet të përpiqen që t'i identifikojnë të gjitha burimet e lajmeve. Praktikë më e mirë është që gazetarët të përdorin burime anonime vetëm kur këto janë të besueshme dhe janë në gjendje të kenë njohuri të drejtpërdrejta për informacionin. Informacioni duhet të jetë i rëndësishëm dhe jo opinion apo spekulim.<sup>34</sup> Organizatat profesionale të medias kërkojnë më shumë se një burim të vetëm për materiale të diskutueshme apo të kontestueshme, si dhe të shpjegohet pse burimi ka kërkuar anonimitet dhe, nëse është e mundur, edhe motivin e burimit për zbulimin e informacionit.

Gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias gëzojnë të drejtën që të mos i zbulojnë burimet e tyre të informacionit në shumicën e rasteve.<sup>35 36</sup> Ata e kanë detyrimin të mbrojnë identitetin e atyre që japin informacione në fshehtësi.<sup>37</sup> Megjithatë, gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias janë të detyruar të zbulojnë identitetin e një burimi anonim vetëm me kërkesë të gjykatës kompetente për padinë përkatëse. Kjo duhet të ndodhë vetëm nëse gjykata përcakton se interesi legjitim për zbulim tejkalon qartë interesin publik për moszbulim.<sup>38 39</sup>

## 2.2 Prezumimi i pafajësisë

Mediat duhet të mbështesin të drejtën e të gjithë të akuzuarve dhe të pandehurve për t'u prezumuar të pafajshëm derisa të provohet fajësia.

Mediat duhet t'i mbajnë parasysh të drejtat e të pandehurve gjatë raportimit për procedurat penale, duke përfshirë të drejtën për t'u prezumuar i pafajshëm derisa të provohet fajësia.<sup>40 41 42</sup> Gazetarët duhet të mbrojnë të drejtën e privatësisë së të dyshuarve dhe personave të akuzuar.<sup>43</sup> Pavarësisht nëse personi është i akuzuar apo i dyshuar, gazetarët duhet të kenë kujdes dhe ndjeshmëri kur vendosin nëse do të publikojnë emrin e personit, si dhe sasinë e informacionit dhe historikun personal rreth tyre.<sup>44 45</sup> Gazetarët duhet të respektojnë çdo urdhër gjykatë për të mos publikuar informacione për të akuzuarit.<sup>46</sup>

## 2.3 Raportimi i baraspeshuar

Ngjashëm me prezumimin e pafajësisë dhe kërkesat për paanshmëri, gazetarët që mbulojnë gjykatat kanë detyrim etik për të raportuar storje në mënyrë të paanshme dhe të baraspeshuar.<sup>47</sup> Për ta arritur këtë qëllim, gazetarët duhet të paraqesin këndvështrimin e dy palëve kundërshtare në çdo proces gjyqësor penal apo civil. Gazetarët duhet të jenë të kujdesshëm që të mos shtrembërojnë ose keqpërdorin deklaratat e bëra në një kontekst të caktuar.<sup>48</sup> Gazetarët që raportojnë për proceset gjyqësore duhet të respektojnë dhe pasqyrojnë faktet dhe të drejtën e publikut për të ditur të vërtetën. Gazetarët duhet t'u përmbahen standardeve ndërkombëtare të sjelljes dhe diversitetit etnik, kombëtar, racor, gjinor, seksual, kulturor dhe fetar.<sup>49</sup>

## 2.4 Privatësia dhe mbrojtja e viktimave

Gazetarët duhet të raportojnë për tragjeditë personale vetëm kur kjo është çështje me interes publik.<sup>50</sup> Ata duhet t'u shmangen ndërhyrjeve dhe hulumtimeve në jetën private të një personi, të respektojnë dinjitetin e viktimave dhe familjeve të tyre dhe t'i



lejojnë njerëzit të mbajnë zi privatisht, si në rastet e krimeve të dhunshme.<sup>51 52 53 54</sup> Ata nuk duhet të publikojnë fotografi apo video nga vendi i krimit pa mbuluar identitetin apo trupin e viktimave. Gjithashtu, ata nuk duhet të publikojnë lajme me fotografi apo video të viktimave apo personave të zhdukur dhe as t'i identifikojnë të njëjtit me emër dhe mbiemër në raportim. Gazetarët duhet t'i shmangen doemos zbulimit të çfarëdolloj informacioni që mund të zbulojë potencialisht identitetin e një viktime të sulmit seksual.

## **2.5 Mbrojtja e të miturve dhe të rriturve të cenueshëm**

Nëse interesi publik është i madh, gazetarët duhet të kenë ndaj fëmijëve të prekur nga tragjedia qasje me mirëkuptim, mbrojtje të privatësisë, dhe diskrecion.<sup>55 56 57</sup> Gazetarët nuk duhet të intervistojnë ose fotografojnë fëmijë nën moshën 18 vjeç pa pëlqimin e prindit ose të rriturit përgjegjës për fëmijën. Mediat asnjëherë nuk duhet të publikojnë emrin dhe mbiemrin, fotografi, video apo pamje të tjera të fëmijëve të përfshirë në aksidente, dhunë, vepra penale, fatkeqësi natyrore apo incidente tjera traumatike. Në rastet kur mediat publikojnë fotografi, video ose pamje të tjera të fëmijëve ose të personave të tjerë, ku shfaqen me fëmijë, atëherë obligohen që t'i mbulojnë fytyrat dhe shenjën dalluese të fëmijës.<sup>58 59</sup> Gazetarët duhet të marrin parasysh ndikimin e dëmshëm që zbulimi i informacionit që mundëson identifikimin e tyre mund të ketë tek të miturit ose personat e tjerë të cenueshëm.<sup>60 61 62</sup>

## **2.6 Mbrojtja e dëshmitarëve**

Është e rëndësishme që të ushtrohet kujdes kur raportohet për dëshmitarët e përfshirë në procedurë penale. Gazetarët asnjëherë nuk duhet të publikojnë identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur pa pëlqimin e tyre.<sup>63</sup> Një zbulim i tillë rrezikon vënien e jetës dhe/ose sigurisë së tyre në rrezik dhe mund të ndërhyjë në procedurat gjyqësore.<sup>64 65 66</sup> Nëse gazetarët nuk i binden urdhrat të gjykatës për mospublikim të emrave të dëshmitarëve të mbrojtur, gjyqtarët mund t'i dënojnë për mosbindje ndaj gjykatës. Mosbindja ndaj urdhrat të gjykatës dënohet me gjobë ose me burgim.<sup>67</sup>

# 3. KORNIZA NORMATIVE DHE LIGJORE QË RREGULLON RAPORTIMIN NGA GJYKATA

## 3.1. Zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të paraqitura në vijim, garantohen me Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Kosovë dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Këto dokumente pranohen gjerësisht si bazë për të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Komponentët kryesorë, megjithëse ka edhe të tjerë, të cilave iu është referuar në këto udhëzime për raportimin nga gjykata janë:

### **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut<sup>68</sup>**

- **Neni 10** – E drejta për një gjykim të drejtë dhe publik

### **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike<sup>69</sup>**

- **Neni 14** – Të drejtat e prezumimit të pafajësisë dhe për një gjykim të lirë dhe të drejtë
- **Neni 17** – E drejta për privatësi
- **Neni 19** – Të drejtat për lirinë e shprehjes dhe informimit

### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>70</sup>**

- **Neni 6** – E drejta për proces të drejtë gjyqësor
- **Neni 8** – E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare
- **Neni 10** – E drejta për lirinë e shprehjes

## **Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec (2003)13 për shtetet anëtare për dhënien e informacionit përmes mediave në lidhje me procedimet penale<sup>71</sup>**

- **Parimi 1** – Informimi i publikut përmes mediave
- **Parimi 2** – Prezumimi i pafajësisë
- **Parimi 3** – Saktësia e informacionit
- **Parimi 4** – Qasja në informacion
- **Parimi 5** – Mënyrat e dhënies së informacionit gjatë procedurës penale
- **Parimi 6** – Informimi i rregullt gjatë procedurës penale
- **Parimi 8** – Mbrojtja e privatësisë në kontekstin e procedurës penale në zhvillim e sipër
- **Parimi 9** – E drejta e korrigjimit ose e drejta e reagimit
- **Parimi 12** – Pranimit i gazetarëve
- **Parimi 15** – Mbështetje për raportimin në media
- **Parimi 16** – Mbrojtja e dëshmitarëve

## **Rekomandimi nr. R (2000) 7 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në fushën e mediave dhe shoqërisë së informacionit<sup>72</sup>**

- **Parimi 1** – E drejta e gazetarëve për moszbulim të burimit
- **Parimi 2** – E drejta për moszbulim të personave të tjerë
- **Parimi 3** – Kufizimet ndaj së drejtës së moszbulimit

## **Konventa e OKB-së për të Drejtën Ndërkombëtare të Korrigjimit<sup>73</sup>**

## **Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës<sup>74</sup>**

### **3.2 Pasqyrim përgjithshme e strukturës së gjykatave në Kosovë**

Struktura e gjyqësorit të Kosovës përbëhet nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykata Ekonomike dhe shtatë Gjykata Themelore në shtatë rajone që mbulojnë tërë territorin e Kosovës. Çdo rajon përfshin gjithashtu degë të shumta të gjykatave themelore që mbulojnë territorin e një komune të caktuar. Për mbrojtjen e lirisë së shprehjes, pasi kanë shteruar të gjitha mjetet ligjore, palët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, e cila mbron të drejtat themelore.<sup>75</sup>

## Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kompetencat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë të parapara me Kushtetutë dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK)<sup>76</sup>, sipas të cilit Këshilli ka rolin themelor për të garantuar pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor. Sekretariati ndihmon Këshillin për zbatimin e rregullave dhe politikave të tija në lidhje me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e gjykatave.

## Gjykata Supreme e Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka juridiksion në tërë territorin e Kosovës. Ajo përfshin Kolegjin e Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Ajo shqyrton dhe gjykon lëndët në panel në përbërje të tre (3) gjyqtarë profesionistë, përveç rasteve kur ligji kërkon numër më të madh të gjyqtarëve.

Gjykata Supreme është kompetente për:

- kërkesat për mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- ankesa kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së dytë për çështjet kontestimore;
- ankesat në shkallën e tretë të lejuara me ligj;
- qëndrimet parimore, opinionet juridike dhe udhëzimet për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës;
- rastet e Agjencisë Kosovare të Pronës;
- vendimet në Dhomën e Posaçme, rastet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ose Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit;
- dhe çdo çështje tjetër të paraparë me ligj.

Gjykata Supreme mund të thërrasë seancë të përgjithshme të të gjithë gjyqtarëve të saj për të nxjerrë qëndrime parimore, opinione ligjore dhe udhëzime që promovojnë zbatimin unik të ligjeve.

## Gjykata e Apelit e Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës është gjykatë e shkallës së dytë që gjykon rastet ndaj të cilave është ushtruar ankesë pas procedurave në cilëndo nga shtatë gjykatat themelore. Ajo përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti i Krimeve të Rënda, Departamenti Special për rastet nën juridiksionin e Prokurorisë Speciale të Kosovës; Departamenti i Çështjeve Ekonomike, Departamenti i Çështjeve Administrative dhe Departamenti për të Mitur.<sup>77</sup>

## Gjykatat themelore të Kosovës

Gjykatat themelore të Kosovës<sup>78</sup> shërbejnë si autoritet fillestar gjykues (të cilave iu referohen si shkalla e parë) në të gjitha rastet. Të shtatë gjykatat themelore kanë juridiksion në këto rajone: Prishtinë, Ferizaj, Gjiilan, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Mitrovicë. Ato kanë departamente të ndryshme, duke përfshirë Departamentin e Përgjithshëm (Divizioni Penal dhe Civil), Departamentin e Krimeve të Rënda dhe Departamentin e të Miturve.

### 3.3 Struktura e Prokurorisë së Kosovës

Struktura prokuroriale e Kosovës përbëhet nga Zyra e Kryeprokurorit<sup>79</sup> si instanca më e lartë me juridiksion në tërë territorin e Kosovës. Prokuroria e Apelit shërben si shkallë e dytë në rastin e ankesës me juridiksion në mbarë Kosovën dhe përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti për të Mitur. Prokuroria Speciale është organ i specializuar prokurorial, me juridiksion në mbarë Kosovën. Janë shtatë prokurori themelore që përbëhen nga departamentet e përgjithshme, departamentet për të mitur dhe departamentet e krimeve të rënda.<sup>80</sup>

## Këshilli Prokurorial i Kosovës

Si institucion i pavarur, Këshilli Prokurorial i Kosovës mbikëqyr dhe siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional dhe i paanshëm.<sup>81</sup>

## Kryeprokurori i Kosovës

Kryeprokurori i Kosovës është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për çfarëdo vepre penale apo për ndonjë vepër tjetër siç parashihet me ligj.<sup>82,83</sup>

## Prokuroria e Apelit

Prokuroria e Apelit është themeluar për të vepruar pranë Gjykatës së Apelit dhe përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti i të Miturve.<sup>84</sup> Prokurorët e emëruar në Prokurorinë e Apelit janë të specializuar për përfaqësimin e ndjekjes penale pranë Gjykatës së Apelit. Kompetencë e Prokurorisë së Apelit është që të bëjë propozime për ankesa, të vendosë për konfliktet e juridiksionit mes prokurorive themelore dhe të shqyrtojë çështje të tjera të parapara me ligj.<sup>85</sup>

## Prokuroria Speciale e Kosovës

Prokuroria Speciale e Kosovës ka juridiksion në tërë territorin e Kosovës dhe përbëhet nga katër departamente: krimet e luftës, krimi i organizuar, terrorizmi dhe korrupsioni dhe krimi financiar.<sup>86</sup>

### 3.4 Instrumentet/korniza kryesore ligjore e Kosovës

Ligjet kryesore të Kosovës të cilave iu është referuar në këto udhëzime për raportimin nga gjykata, megjithëse ka të tjera, janë:

#### Kushtetuta e Kosovës:<sup>87</sup>

- **Neni 31** – E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm
- **Neni 40** – Liria e shprehjes
- **Neni 41** – E drejta e qasjes në dokumente publike
- **Neni 42** – Liria e mediave
- **Neni 109** – Prokurori i shtetit
- **Neni 110** – Këshilli Prokurorial i Kosovës

### **Kodi i procedurës penale të Kosovës:**<sup>88</sup>

- **Neni 293** – Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor
- **Neni 294** – Përjashtimi i publikut
- **Neni 296** – Forcat e rendit dhe media në gjykatë
- **Neni 289** – Seancat e mbyllura gjatë shqyrtimit gjyqësor
- **Neni 530** – Njoftimet e pabazuara në media

### **Ligji i Kosovës për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë:**<sup>89</sup>

- **Neni 4** – E drejta për të heshtur për burimet

### **Kodi penal i Kosovës:**<sup>90</sup>

- **Neni 392** – Shkelja e fshehtësisë së procedimit
- **Neni 401** – Mospërfillja e gjykatës

### 3.5 Shprehjet kryesore

Në këtë pjesë janë paraqitur shprehjet kryesore që gazetarët duhet t'i kuptojnë kur raportojnë nga gjykatat ose lidhur me to. Shprehjet e mëposhtme dhe përkufizimet e ndërlidhura burojnë nga Doracaku themelor ligjor për gazetarët, i përpiluar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë.<sup>91</sup>

**I AKUZUAR** – Personi ndaj të cilit është ngritur aktakuzë dhe për të cilin është caktuar shqyrtimi gjyqësor.

**AKTGJYKIM LIRUES** – Vendimi i gjykatës që i pandehuri të shpallet i pafajshëm për vepër penale. Aktgjykimi lirues nuk është konstatim i pafajësisë, por është thjesht një përfundim se prokuroria nuk e ka vërtetuar akuzën e saj.

**ANKESË** – Kërkesë në një gjykatë më të lartë për të rishikuar dhe ndryshuar vendimin në një çështje të vendosur nga një gjykatë më e ulët.

**MOSPËRFILLJE E GJYKATËS** – Veprimet e palëve në procedurë me të cilat tregohet mosbindje ose mungesë respekti ndaj një gjykate ose/dhe një gjyqtari.

**PERSON I DËNUAR** – personi i cili me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës shpallet fajtor për kryerjen e veprës penale.

**I PANDEHUR** – Personi ndaj të cilit zhvillohet procedura penale. Shprehja përdoret gjithashtu si shprehje e përgjithshme për "të akuzuarin" dhe "personin e dënuar".

**AKTVENDIM** – Dekret ose vendim gjyqësor i bazuar në analizën juridike dhe faktike të një çështjeje që është shqyrtuar ose në proces gjyqësor.

**FAJTOR** – gjykimi nga një gjyqtar ose i trup gjykues në lidhje me personin që është akuzuar për vepër penale, i cili vërteton ligjërisht fajësinë e tij/saj.

**IMUNITET** – Mbrojtje kundër arrestimit dhe ndjekjes penale.

**AKTAKUZA** – Akuza formale e lëshuar nga prokurori ku thuhet se ka prova të mjaftueshme që i pandehuri ka kryer veprën penale për të arsyetuar mbajtjen e një gjykimi.

**PALA E DËMTUAR APO VIKTIMA** – personi i cili ka pësuar dëm ose humbje që është shkaktuar nga vepra penale.



**AKTGJYKIM** – Vendimi ligjor zyrtar i formës së prerë nga një gjykatë në një padi, ndjekje penale ose ankesë ndaj një vendimi të një gjykate më të ulët.

**PADI** – Shprehje e zakonshme për një veprim juridik në çështjet e së drejtës civile, administrative dhe tregtare që inicohet nga një person ose subjekt kundër një personi ose subjekti tjetër me qëllim që të vendoset në gjykatë.

**PARAGJYKIMET E MEDIAS** – Ndodhin kur media (individualisht ose kolektivisht) raporton diçka që është e pasaktë ose e njëanshme për shkak të ideologjisë, favorizimit politik ose faktorëve të tjerë.

**FJALA HYRËSE** – Zakonisht procedura e seancës gjyqësore fillon me fjalën hyrëse të kryetarit të trupit gjykues, kështu që konstatohet prania e të gjitha palëve dhe pjesëmarrësve që janë ftuar, si dhe sigurohet se nuk ka pengesa për vazhdimin e seancës.

**PADITËS** – Personi që bën padi civile. Quhet gjithashtu pala pretenduese ose ankuesi.

**KRYETARI I TRUPIT GJYKUES** – gjyqtari në departamentin e krimeve të rënda të gjykatës themelore i cili e pranon aktakuzën, merr vendim për të gjitha kërkesat preliminare dhe të provave në shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, dhe kryeson trupin gjykues që gjykon në shqyrtimin gjyqësor.

**PROKUROR** – zyrtar publik i cili është përgjegjës për ndjekjen penale të personave që shkelin ligjin, brenda juridiksionit të një gjykate të caktuar.

**I DYSHUAR** – Personi ndaj të cilit ekziston dyshimi i arsyeshëm se ka kryer vepër penale.

**GJYQTARI I VETËM** – gjyqtari në departamentin e përgjithshëm të gjykatës themelore i cili pranon aktakuzën, merr vendim për të gjitha kërkesat paraprake dhe të provave në shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, dhe gjykon në shqyrtim gjyqësor. Krahasoni me përkufizimin e kryetarit të trupit gjykues.

**GJYKIMI** – Shqyrtim gjyqësor i mbajtur në gjykatë për të shqyrtuar faktet në një rast të caktuar me qëllim të nxjerrjes së një vendimi për dënimin ose lirimin e të pandehurit.

**TRUPI GJYKUES** – trupi i përbërë prej kryetarit të trupit gjykues dhe dy gjyqtarëve profesionistë të cilën shqyrtojnë provat dhe gjykojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

### 3.6 Kodet e sjelljes dhe instrumentet e vetërregullimit

Kodet e sjelljes dhe organet vetërregulluese janë elementë thelbësorë që kontribuojnë në një praktikë të baraspeshuar dhe etike të gazetarisë. Në Kosovë, Kodi i Komisionit të Pavarur për Media dhe Kodi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës luajnë një rol të rëndësishëm.<sup>92 93</sup> Gazetarët janë të detyruar që t'u përmbahen këtyre kodeve në mënyrë që t'i respektojnë standardet profesionale dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të gazetarisë.


Kodi i etikës për ofruesit e shërbimeve mediale i Komisionit të Pavarur të Mediave përcakton rregullat etike për ofruesit e shërbimeve mediale. Nenet 1 dhe 2 paraqesin qëllimin dhe fushëveprimin. Nenet tjerë trajtojnë standardet e mëposhtme që janë të pranuar në nivel ndërkombëtar:<sup>94</sup>

- **Neni 3** – Përmbajtja e dëmshme dhe fyese
- **Neni 4** – Gjuha vulgare dhe ofenduese
- **Neni 5** – Nxitja e urrejtjes
- **Neni 6** – Paanshmëria dhe saktësia e lajmit
- **Neni 7** – Të drejtat individuale
- **Neni 8** – Programet fetare
- **Neni 9** – Paraqitja dhe përfshirja e fëmijëve dhe të miturve në programet e ofruesve të shërbimeve mediale
- **Neni 10** – E drejta për reagim
- **Neni 11** – Sanksionet



## Kodi i mediave të shkruara i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës mbulon parimet kryesore të raportimit etik që kanë të bëjnë me sa vijon:<sup>95</sup>

- I. Detyrat dhe përgjegjësitë e gazetarëve dhe botuesve
- II. Raportimi i së vërtetës dhe lajmet e rreme
- III. Nxitja e gjuhës së urrejtjes
- IV. Të drejtën për reagim
- V. Personat e përfshirë në incidente, aksidente, të arrestuar apo të akuzuar për vepra penale
- VI. Trajtimi i tragjediave personale, mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve
- VII. Privatësia dhe mbrojtja e burimeve



# REFERENCAT

1. Shih nenet 293 - 296 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
2. Shih nenin 31(3) të Kushtetutës së Kosovës.
3. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 1, Rekomandimet dhe Deklaratat e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në fushën e medias dhe shoqërisë së informacionit, 2016.
4. Po aty.
5. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 12.
6. Shih nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).
7. Shih nenin 14, PNDCP.
8. Shih nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (UDHR).
9. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 15.
10. Gazetarët mund të kenë qasje në oraret e gjykimeve përmes faqes së internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës: <https://www.gjyqesori-rks.org/>. Klikoni në orarin e gjykatës së cilës dëshironi t'i qaseni nga shiriti i sipërm i faqes kryesore. Më pas, klikoni butonin Orari nga shiriti i sipërm i faqes kryesore të gjykatës përkatëse. Për shembull, vegëza në vijim i drejton përdoruesit te orari i gjykimeve në Gjykatën Themelore të Prishtinës: <https://prishtine.gjyqesori-rks.org/>, ndërsaq vegëza <https://apeli.gjyqesori-rks.org/?lang=en> i drejton te oraret e gjykimeve të Gjykatës së Apelit.
11. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimet 3-6.
12. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 15.
13. Shih nenin 296 dhe nenet 301 – 302 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
14. Shih nenet 40 dhe 41, Kushtetuta e Kosovës.
15. Shih nenin 19, PNDCP.
16. Po aty.
17. Shih nenin 296, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.
18. Po aty.
19. Shih nenin 14, PNDCP.
20. Shih nenin 294 dhe 296 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
21. Po aty.
22. Shih nenin 294 dhe 296 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
23. Shih nenin 14, PNDCP.
24. Shih nenin 401 të Kodit Penal të Kosovës.
25. Shih Rregulloren nr. 03/2019 për shërbimin e komunikimit me publikun në sistemin prokurorial të Këshillit Prokurorial, neni 5, 2019.
26. Shih Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare të Korrigjimit.
27. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 9.
28. Shih nenin 4 të Kodit të mediave të shkruara të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Për më shumë informacion, shihni: <http://presscouncil-ks.org/about-us/document-list/?lang=en>.
29. Shih nenin 42, Kushtetuta e Kosovës.
30. Shih nenin 530, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.
31. Shih nenet 6 dhe 10 të Kodit të etikës për ofruesit e shërbimeve mediale të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM). Për më shumë informacion, shih: <https://rb.gy/9a0e4>.
32. Shih nenin 530, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.
33. Po aty.
34. Shih Nenin 2, Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.

35. Shih Ligjin Nr. 04/L-137, Neni 4 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, 23 gusht 2013.
36. Shih CM/Rec (2000) 7, Parimet 1-3, Rekomandime dhe deklarata të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në fushën e medias dhe shoqërisë së informacionit, 2016.
37. Shih Nenin 7, Kodi i mediave të shkruara të Kosovës.
38. Shih CM/Rec (2000) 7, Parimet 1-3.
39. Shih Nenin 7, Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
40. Shih nenin 14(2), PNDPC.
41. Shih nenin 31(5), Kushtetuta e Kosovës.
42. Shih Neni 6(2), KEDNJ.
43. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 8.
44. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 2.
45. Neni 7, Kodi i Etikës i KPM-së.
46. Shih nenin 5(3), Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
47. Neni 6, Kodi i Etikës i KPM-së.
48. Shih nenin 2(8), Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
49. Shih nenet 2(4) dhe 3(2), Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
50. Shih nenin 6(5), Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
51. Shih nenin 8, KEDNJ.
52. Shih nenin 6(6), Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
53. Shih nenin 7(1), Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
54. Shih nenet 6 dhe 7, Kodi i Etikës së KPM-së.
55. Shih nenin 6, Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
56. Shih nenet 3 dhe 16 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.
57. Shih nenin 9, Kodi i Etikës i KPM-së.
58. Shih nenin 6, Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
59. Shih nenin 6(2), Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.
60. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 8.
61. Shih nenin 6, Kodi i Etikës i KPM-së.
62. Personat e cenueshëm ose të marginalizuar sipas të drejtës ndërkombëtare mund të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara, pjesëtarët e komunitetit joshumicë, popujt indigjenë, refugjatët, punëtorët migrantë dhe të varfërit. Referojuni Pjesës I, Paragrafit 24 të Deklaratës së Vjenës dhe Programit të Veprimit për më shumë informata për detyrimet e shteteve për të themeluar dhe pasur mekanizma për mbrojtjen e këtyre grupeve.
63. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 16.
64. Shih CM/Rec (2003) 13, Parimi 16.
65. Shih nenin 392(3), Kodi Penal i Kosovës.
66. Shih nenin 296, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.
67. Shih nenin 401, Kodi Penal i Kosovës.
68. DUDNJ.
69. PNDPC.
70. KEDNJ.
71. Shih CM/Rec (2003) 13.
72. Shih CM/Rec (2000) 7.
73. Shih Konventën e OKB-së për të Drejtën Ndërkombëtare të Korrigjimit.
74. Shih Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.
75. Shih Ligjin Nr. 22/18, neni 10 për Ligjin për Gjykatat, 18 dhjetor 2018.

76. Për një diskutim më të hollësishëm, shih faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës: <https://www.gjyqesori-rks.org/info-te-pergjithshme-fakte-kyce/?lang=en>
77. Shih Ligjin Nr. 06/L-054, neni 24 për organizimin e Gjykatës së Apelit, 18 dhjetor 2018.
78. Shih Ligjin Nr. 06/L-054, neni 12(1) për juridiksionin e gjykatave themelore, 18 dhjetor 2018.
79. Shih Ligjin Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, 17 maj 2023.
80. Ligji Nr.03/L –225 për Prokurorin e Shtetit, 29 tetor 2010.
81. Shih Ligjin Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, 3 Prill 2019.
82. Për një diskutim më të hollësishëm, shih faqen e internetit të Prokurorit të Shtetit: <https://prokuroria-rks.org/en/psh/per-psh/71/>.
83. Shih nenet 109(4) dhe 110(3), Kushtetuta e Kosovës.
84. Shih nenin 16, Ligji Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit.
85. Për një diskutim më të hollësishëm, shih faqen e internetit të Prokurorit të Shtetit: <https://prokuroria-rks.org/en/psh/per-psh/71/>.
86. Po aty.
87. Shih Kushtetutën e Kosovës. Nene të tjera kyçe në kontekstin e referencave të udhëzimeve ndaj marrëveshjeve dhe mekanizmave ndërkombëtarë përfshijnë neni 17: Marrëveshjet ndërkombëtare; Neni 18: Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare; Neni 19: Zbatueshmëria e së drejtës ndërkombëtare, neni 20: Delegimi i sovranitetit dhe neni 22: Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare.
88. Shih Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.
89. Shih Kodin nr. 04/L-137, neni 4.
90. Shih Kodin Penal të Kosovës.
91. Shih Dragusha, Musa, Doracak themelor ligjor (Prishtinë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, 2014) f. 47-62.
92. Për më shumë informata, shih Kodin e etikës për ofruesit e shërbimeve mediale të Komisionit të Pavarur të Mediave: <https://rb.gy/9a0e4>.
93. Për më shumë informata, shih Kodin e Mediave të Shkruara të Këshillit të Mediave të Kosovës: <http://presscouncil-ks.org/about-us/document-list/?lang=en>.
94. Shih Kodin e etikës për ofruesit e shërbimeve mediale të Komisionit të Pavarur të Mediave.
95. Për më shumë informata, shih Kodin e mediave të shkruara të Këshillit të Mediave të Kosovës.



